

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVO
Ministria e Shëndetësisë / Ministrastvo Zdravstva - Ministry of Health
Agjencioni Kosovari për Produktë Medicinale / Kosovska Agencija za Medicinske Proizvode
Kosovar Medicines Agency

Njësitë Org.
Org. Jedin.
Org. Unit. 01

Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No. 3450

Nr. i faqeve
Broj stranica
No. pages: -04-

Data
Datum
Date 23.07/2019

PRISHTINE/A



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR / FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE
HEALTH INSURANCE FUND

Njësitë Org.
Org. Jedinica
Org. Unit. FSSH

Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No. 1464

Nr. i faqeve
Br. stranica
No. pages: -4-

Data
Datum
Date 15.07.19

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

MARREVESHJE E BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET

FONDIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

DHE

**AGJENCISË SË KOSOVËS PËR PRODUKTE DHE
PAJISJE MEDICINALE**

PASI QË, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (në tekstin e mëtejshëm: "FSSH") dhe Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (në tekstin e mëtejshëm "AKPPM") janë dakorduar për këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejshëm 'Marrëveshja').

DUKE QENË SE, FSSH dhe AKPPM (më tej referohen bashkërisht si "palët") kanë qëllime të ngjashme, në sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe shërbime tjera të ndërlidhura në nivel më të lartë dhe më kualitativ, si dhe për të mbështetur arritjen e objektivave sektoriale duke vendosur standard në ofrimin e kujdesit shëndetësor në Republikën e Kosovës;

SI RRJEDHOJË, palët kanë rënë dakord të sforcojnë bashkëpunimin e tyre në bazë të kësaj Marrëveshje të bashkëpunimit dhe të vendosin kornizat e bashkëpunimit për zbatimin e plotë të kësaj Marrëveshje.

1. QËLLIMI

1.1 Qëllimi i Marrëveshjes është ngritja e bashkëpunimit në mes të palëve në çështjet me interes të përbashkët dhe me theks të veçantë në shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Sistemit Informativ të FSSH-së ("SIF") dhe Sistemit Informativ të AKPPM ("Barnatari").

1.2.1 Kjo Marrëveshje përcakton kushtet nën të cilat palët mundësojnë shkëmbimin e informatave në bazën e të dhënave të sistemeve përkatëse.

2. PËRDORIMI I TË DHËNAVE

2.1 Përdorimi i të dhënave do të mundësohet përmes leximit të tyre (marrjes), përmes një Ueb Shërbimeve (ose Ueb API-ve) dhe do të jenë te qasshëm vetëm nga përdorues të autorizuar.

2.2 Palët hartojnë udhëzues (procedura) për shkëmbimin e të dhënave, që është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, përmes të cilëve do të definohet lloji i të dhënave të cilat do të shkëmbehen në nivel teknik të informatave.

3. ZOTIMET E FSSH-së

3.1. FSSH siguron teknologjinë e duhur që do të shfrytëzohet si urë lidhëse ndërmjet sistemeve.

3.2. FSSH-ja zotohet të mbajë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.

3.3. FSSH-ja zotohet që të dhënat të dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshje dhe të njëjtat nuk do të shpërndahen për palë të tjera të paautorizuara.

4. ZOTIMET E AKPPM-së

4.1. AKPPM-ja siguron teknologjinë e duhur që do të shfrytëzohet si urë lidhëse ndërmjet sistemeve.

4.2. AKKPM-ja zotohet të mbajë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.

4.3. AKKPM-ja pajtohet që të dhënat që janë në pronësi apo më të cilat disponon të i vë në dispozicion të FSSh-së në kohë reale, përmes qasjes në bazën e saj të të dhënave. Këto të dhëna përfshijnë, por nuk kufizohen në,:

4.3.1 të dhënat për secilën licence të lëshuar (emri i barnatores, adresa, pronari, numri i biznesit dhe farmacisti përgjegjës), dhe

4.3.2 të dhënat për secilin bar që ka autorizim marketingu për Kosovë, përfshirë kodin e veçantë për çdo specifikim të ndryshëm të atij bari.

5. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

5.1. Të dhënat që shkëmbehen në mes të FSSh-së dhe MSh-së nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar.

5.2. Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga kjo Marrëveshje duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. AFATI DHE AMANDAMENTIMI

6.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga të dy Palët dhe do të mbetet i vlefshëm për afat të pacaktuar, përveç nëse përfundon më herët sipas pikës 6.3.

6.2 Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me dakordim të ndërsjellë me shkrim të palëve. Palët mund të ndryshojnë ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshje ose të hyjnë në aranzhime plotësuese të disanjuara për të përcaktuar më tej fushëveprimin e kësaj Marrëveshje.

7. MARRËDHËNIET E PALËVE

7.1 Për qëllimet e kësaj Marrëveshje asnjëra palë nuk do të ketë autorizime për të bërë ndonjë deklaratë, përfaqësim ose angazhim të çfarëdo lloji, ose për të ndërmarrë ndonjë veprim i cili do të jetë detyrues për palën tjetër, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht në këtë Marrëveshje ose të autorizuar me shkrim nga pala tjetër.

8. PËRGJEGJËSIA

- 8.1 Secila Palë do të jetë përgjegjëse vetëm për mënyrën në të cilën ajo kryen pjesë të aktiviteteve të bashkëpunimit në bazë të kësaj marrëveshje dhe / ose ndonjë marrëveshje tjetër. Kështu që, asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje, aksident, dëmtim i është shkaktuar ose e ka shkaktuar Pala tjetër, ose nga punonjësit, konsulentët ose nën-kontraktorët e palës tjetër, në lidhje me ose si rezultat i bashkëpunimit për realizmin e aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshje.

9. HYRJA NË FUQI


- 9.1 Palët pajtohen që kjo Marrëveshje fillon së zbatuari në ditën e nënshkrimit nga Palët.
- 9.2 Kjo marrëveshje nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale dhe me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, palët obligohen në zbatimin e plotë të saj.

Për:
Fondin e Sigurimeve Shëndetësore


Fatmir Plaqi,
Drejtor



Për:
Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe
Pajisje Medicinale


Arian Ahmeti
U.D. Kryeshef Ekzekutiv



Prishtinë,
4 korrik 2019